



Ndërmarrja publike lokale EKO-THERANDA



Adresa: Rruga Brigada 123, Nr.2 , 23000 Suharekë NUI:812186999, e-mail: ekotherandasha@gmail.com

Në bazë të dispozitave të Nenit 8 të Ligjit të Punës, Udhëzimit Administrativ 01-2024, si dhe Rregullores për Procedurat e punësimit Nr.01-893/2, date 29.10.2024 Nr.01/2024, në bazë të Rregullores për Organizimin e Brendshëm të NPL "EKO-THERANDA", nr.12/2025, nenit 26 pika 5 të kësaj rregullore, si dhe në bazë të Vendimit të Bordit Nr.162 /2026, të datës: 07.09.2026, Ndërmarrja Publike Lokale EKO-THERANDA Sh.A në Suharekë, shpall:

KONKURS

Për plotësimin e vendit të punës

VENDI I PUNES: Shërbimi i mirëmbajtjes

Emërtimi i vendit të punës: Kryepunëtor/e

Përgatitja profesionale/shkollore: E mesme, shkathtësi në punë.

Përvoja e punës: Se paku 1 vit

Orët e Punës: 40 orë në javë

Koeficienti i pagës: 6.5

I raporton: Kryeshëfit Ekzekutiv të NPL-së

Kohëzgjatja e Kontratës: Me kohë të pa caktuar (puna provuese 6 muaj)

Vendi Punës: Rr. "Brigada 123" nr.2, 23000 Suharekë (selia e NPL EKO-THERANDA)

Përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësi të punës:

1. Organizon dhe koordinon punën e punëtorëve në ndrrime, cakton punëtorët dhe automjetet në kryerjen e punës së përditëshme operative në reonin e caktuar.
2. Mban evidence për çdo punëtorë në reonin e vetë dhe kryen llogarin e efektit të punës për çdo punëtorë.
3. Përpilon planin ditore dhe mujor të punës në bazë të planit operativ
4. Përcjell dhe kontrollon shfrytëzimin e kohës së punës për çdo punëtorë, i evidenton dhe raportin e dorëzon në administrat dhe operative si dhe ditarin e punëve të kryera i dorëzon udhëheqësit të sektorit/KE-së.
5. Kontrollon realizimin e detyrave ditore të punëtorëve në teren.
6. Të gjitha problemet në teren është i obliguar t'i parashtroj me kohë të KE.
7. Drejtëpërdrejt kontrollon kualitetin e punës në teren dhe ua tërheq vrejten punëtorëve që gjatë kryerjes së punëve të mos i dëmtojnë automjetet.
8. Kërkon nga vozitësit e automjeteve që në teren të sillen korrekt me qytetarët dhe të ndalen për grumbullimin e hedhurinave në vende të përshtatshme ku nuk pengohet komunikacioni dhe lëvizja e qytetarëve.
9. Është përgjegjës për përdorimin e mjeteve mbrojtëse në punë.
10. Kryen edhe punë tjera me urdhëres të Kryeshëfit Ekzekutiv.
11. Për punën e vetë i përgjigjet drjtëpërdrejtë Kyeshëfit Ekzekutiv.

Mënyra e aplikimit;

Aplikimi bëhet në mënyrë fizike tek zyra e NPL EKO-THERANDA e cila gjendet në objektin e Komunës së Suharekës Rr.Brigada 123 nr.2 ose në mënyrë elektronike në adresën: ekotherandasha@gmail.com (Dokumentet duhet të dorezohen në formatin PDF).

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

Dokumentet që duhet të bashkangjiten:

- Aplikacioni i NPL EKO-THERANDA i cili merret në zyret e NPL-së ose në web faqe;
- Dëshmia e Shkollimit;
- Jetë Përshkrimi (CV);
- Dëshmia mbi përvojën e punës së paku 1 vit
- Certifikatën e gjendjes penale të lëshuar nga Gjykata, e cila dëshmon që nuk jeni i/e dënuar apo nën hetime (duhet të jetë jo më e vjetër se gjashtë muaj);
- Kopjen e letërnjoftimit;

Shënim: Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

NPL EKO-THERANDA ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.

Shpallja është e hapur që nga data 08.09.2026 deri më 23.09.2026.

Për informata më të hollësishme mund të kontaktoni në Administratën e NPL EKO-THERANDA e cila gjendet në objektin e Komunës së Suharekës Rr.Brigada 123 nr.2 apo në email: ekotherandasha@gmail.com

NPL "EKO-THERANDA" Sh.A.

